



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KRYETARI
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më 02/07/2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Studim, projektim për objektin “Krijimi i një parku në
Lagjen e Re”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Projekte 22114311-5.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,665,680 një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/**

2.2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% të fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$1,665,680 \times 40\% = 666,272$ (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e dy viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të parashikuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ligjit nr.10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet te kene raport negativ ndertmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP “(i ndryshuar), si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

2.2.3 Vërtetim lëshuar per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, ne perputhje me percaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes se pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kështesave prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1.3.1. 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$1,665,680 \times 20\% = 333,136$ (treqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe piken 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet përvojës së mëparshme, se zoterojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

1.3.2. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Licencën Profesionale të shoqërisë (të vlefshme) për studim projektim në ndërtim, lëshuar nga institucionet e autorizuar sipas legjislacionit në fuqi, lidhur me shërbimet objekt i kontratës, ku të përfshihen, kategoritë si më poshtë:

a. Projektues Arkitekt

2.b-1- Objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara

2.d- Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe

b. Projektues Konstruktor

3.2. Troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët.

c. Projektues Instalator

4.i- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroportive etj.

d. Projektues Gjeodet

8.a- Rivlime inxhinierike.

e. Studim gjeologo-inxhinierik-hidrogeologjik

9.d- Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

f. Projektimi i impianteve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike

10.e- Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm.

g. Projektues të sinjalizimit rrugor

11.a- Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

(Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë njehësimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Autoritetit kompetent në Republikën e Shqipërisë, konform VKM-së Nr. 759, datë 12.11.2014, i ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim*”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë e studim projektimit janë vendosur në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës.

1.3.3. Operatori ekonomik duhet të ketë Drejtuesit Teknikë të Përfshirë në Licencën e Shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) Projektues Arkitekt
- 1 (një) Projektues Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Projektues Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Projektues Inxhinier Gjeodet/ Inxhinier Topograf

Total 4 (katër) Përsona në staf Drejtues Teknik.

Për këtë duhet të paraqesë:

- Diplomë,
- CV,
- Kontratë pune të vlefshme,
- Licencë personale të vlefshme,
- Të figuroj në listpagesen e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma b) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri

kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për këta inxhinier është diktuar nga përvoja dhe legjislacioni në fushën e studim projektimit në ndërtim. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Operatori ekonomik, duhet të paraqes si staf ndihmës si më poshtë:

1 Punonjës të pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.104400, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”

Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Diplomë,

CV,

Kontratë të vlefshme pune,

Licencë personale të vlefshme,

Të figuroj në listëpagesën e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për këta inxhinierë është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni në fushën e studim projektimit në ndërtim. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

1.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e objektit të kontratës duhet të disponojë një numër punonjësish të paktën prej 5 personash (pesë), të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.

- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar,

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Referuar kategorisë së punimeve si dhe afatit, stafi i kërkuar duhet të jetë:

- | | |
|---|----------------|
| • Projektues Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| • Projektues Arkitekt | 1 (një) |
| • Projektues Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| • Projektues Inxhinier Gjeodet/ Inxhinier Topograf | 1 (një) |
| • Punonjës të pajisur me certifikatë
lëshuar nga Ministria e Mjedisit
për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis | 1 (një) |

TOTALI = 5 Persona në Staf (pesë).

Dokumentat për të vërtetuar këtë kriter janë:

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatimeve të Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore të rrethit përkatës ose me vulë elektronike .
- b) Listëpagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma b) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtuesin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për këta inxhinier është diktuar nga përvoja dhe legjislacioni në fushën e studim projektimit në ndërtim. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- a) **ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e

bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi:

Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- b) **ISO 14001 - 2015 - Standard per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi:

Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria e cila punon/ushtron aktivitetin në një zonë prodhimi; e cila përfshin larminë e ajrit, tokës, ujit dhe burimeve natyrore, bimëve dhe kafshëve, dhe qeniet njerëzore dhe shoqërimin e tyre me njëri-tjetrin. ISO 14001 është standardi universal i procesit të monitorimit të përpjekjeve të një organizate drejt mjedisit të saj dhe në një kuptim tjetër të hapave përpara. Është një ndërveprim sistematik që lejon të zbatohet duke i kushtuar vëmendje efekteve rreth tij gjatë periudhës nga faza e parë e prodhimit deri te dorëzimi tek perdoruesit e këtij objekti, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- c) **ISO 45001-2018 Standart per Menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë ne Pune (e vlefshme) ose ekuivalente**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi:

Standarti ISO **45001-2018** është standarde ndërkombëtare, të cilët parashtrojnë kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. Të dy ofrojnë udhëzime që ju ndihmojnë të hartoni dhe ngrini strukturën e kompanisë suaj mbi sigurinë dhe shëndetin në punë – duke ju dhënë mundësinë të sillni të gjithë kontrollin e duhur dhe proceset në një sistem menaxhimi. Përfitimet Standarti ISO **45001-2018** Menaxhimi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë janë krijimi i kushtet më të mira të punës në gjitha ndërmarrjet dhe shoqëritë, identifikojnë kërcënimet dhe vendosin kontrollin për menaxhimin e tyre, reduktojnë aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar

kostot dhe kohën joproduktive të puntoreve, përfshijne dhe motivojne stafin me kushte më të mira dhe më të sigurta pune, dëshmojne përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve të tyre.

Sistemi i manaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundeson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në Kodin e punës, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Ligjin nr.10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM nr. 563, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, VKM nr.312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier si dhe në mbështetje të natyrës së objektit të prokurimit.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës:

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Nr.	Emërtimi i shërbimit	Njësia	Sasia
1	“Studim, projektim për objektin “Krijimi i një parku në Lagjen e Re”.	Shërbim	1

Sipas VKM Nr. 354, datë 18.5.2016 “PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM” seksioni II neni 32, çdo ofertë ekonomike që rezulton jashtë kufirit minimal dhe maksimal të vlerës do të skualifikohet.

Vlera e fondit limit: 1,665,680 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

Informacione të tjera:

Seksioni: Strukturat në ambjentet e jashtme

Grupi tarifor IV

Vlera e projektimit duhet të jetë midis vlerave:

❖ Maksimalja: 1,331,980 (një milion e treqind e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

Për shërbimin topografik gjatë fazës së projektimit Shtojca 1, neni 72.

Grupi tarifor II

Vlera e shërbimit duhet të jetë midis vlerave:

- ❖ Maksimalja: **337,700** (një milion e treqind e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë lekë pa TVSH).

Afatet e ekzekutimit: 2 (dy) muaj nga nënshkrimi i kontratës

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Objekti: “Studim, projektim për objektin “Krijimi i një parku në Lagjen e Re”

Vendodhja e Objektit:

Objekti në fjalë që do të merret në studim ndodhet në territorin e bashkisë Patos në lagjen “e Re” dhe përbëhet nga 2 zona, përkatësisht zona A dhe Zona B. Zona A kufizohet nga segmentet e rrugëve “Sali Alushi” dhe rruga e “Vreshtit”. Zona B shtrihet përgjatë dy rrugëve “Qerim Gropa” dhe rruga e “Vreshtit”. Secila nga zonat ka sipërfaqe si më poshtë:

$Sip_{(zona A)}=2127 \text{ m}^2$; $Sip_{(zona B)}=16,488 \text{ m}^2$;

Qëllimi i Projektit:

Qëllimi i projektit është krijimi i hapësirave rekreative për të gjithë grupmoshat të cilët jetojnë në këtë zonë duke krijuar një destinacion të ri të preferuar për familjet dhe komunitetin.

Nga detyra e projektimit janë shpjeguar dhe analizuar problematikat kyçe të këtyre zonave të cilat duhet të trajtohen nga subjekti projektues duke plotësuar kërkesat e banorëve të zonës dhe duke iu ofruar shërbimet e munguara.

Problematikë për të gjithë grupmoshat që frekuentojnë dhe jetojnë në këtë lagje është mungesa e hapësirave rekreative. Hapësirat e mundëshme për zhvillimin e një parku rekreacioni janë të pa sistemuara, mungojnë parkimet, zona e gjelbëruara, ku gjelbërimi i lartë është zhvilluar në mënyrë të pakontrolluar. Këto dy zona si pasojë e mungesës së investimeve prej vitesh kanë mbetur të pazhvilluara dhe janë kthyer në zona të cilët nuk frekuentohen dhe grumbullohen inerte të cilat hidhen nga qytetarët duke treguar pa përgjegjshmëri në lidhje me mbrojtjen e mjedisit. Krijimi i një parku në qendër të lagjes do të sjellë transformimin duke ofruar një mjedis më të gjelbër, më argëtues për fëmijët e më të këndshëm për qytetarët. Parku rekreativ synon të ndikojë pozitivisht në jetën e përditshme të banorëve, veçanërisht fëmijëve, duke ofruar hapësira të sigurt për lojë dhe argëtim, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e tyre social.

➤ KËRKESAT BAZË NGA PROJEKTI

Faza e parë, inspektimi dhe vlerësimi i objektit të studimit:

Për objektet e përfshira në këtë shërbim subjekti projektues duhet të inspektojë të studjojë e të hartojë sa më poshte:

1. Inspektim vizual dhe përshkrim i gjendjes aktuale dhe konstatimit e problematikave gjatë inspektimit. Analiza e detyrës së projektimit dhe termave të referencës do të përmbajë materialet e nevojshme grafike dhe vërtetuese të situatës, duke formuar bazën e projektit, të paraqitura sipas termave të referencës.
Materiali grafik i përgatitur nga konsulenti duhet të përfshijë:
 - Pozicionimi në hartat;
 - Foto e situatës ekzistuese;
 - Vërtetimi gjeometrik dhe arkitektonik i situatës ekzistuese
 - Verifikimi i projekteve të miratuara për zonën objekt studimi etj.
2. Fletët grafike do të përgatiten bazuar në vërtetimin; ato duhet të jenë lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme.
3. Projekt-ideja e cila propozon rehabilitimin e zonës me të gjithë elementët e nevojshëm infrastrukturorë duke marrë në konsideratë planin e përgjithshëm vendor të qytetit të Patosit.

Faza e dytë, hartimi i projekt-idesë:

1. Kryerja e matjeve topografike dhe matjeve e vlerësimeve të kushteve hidrologjike dhe gjeologjike të zonës në fjalë.
2. Përcaktimin e saktë të sipërfaqes që do të ndërhyhet.
3. Rrjeti i rrugëve që do të rehabilitohet ku të përcaktohet paketa e shtresave përkatëse. Gjatë hartimit të projekteve të infrastrukturës rrugore, të mbahen parasysh Studimet Urbanistike Pjesore (nëse ka) dhe planin e përgjithshëm vendor të qytetit të Patosit. Gjithashtu, për të përcaktuar saktë kapacitetin për të gjitha shërbimet e kërkuara, duhet patur parasysh koeficienti i dendësisë së popullsisë, sipas Rregullores së Urbanistikës në fuqi, si dhe duhen marrë në konsideratë zhvillimet urbane të pritshme dhe në perspektivë të zonës në fjalë. Për hartimin e projektit duhet të mbahen parasysh standartet në fuqi (Rregullorja urbanistikës, Eurocode, KTP, VKM nr. 1096, datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirave publike”).
4. Projekti/skema duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë: Aksesibilitetin për të gjitha kategoritë e grupmoshave, duke përfshirë rastet dhe mjetet e emergjences (sidomos ato të zjarrit, PAK, shëndetit etj); Parashikimin e mënyrës së lidhjes së rruges me akset kryesore dhe blloqet e banimit kufitare;
5. Materialet të përpunohen në format dwg, në AUTOCAD.
6. Siguria dhe sinjalistika rrugore - Sinjalistika do të përfshijë sinjalistikën vertikale dhe horizontale për t'i dhënë përdoruesve të rrugës informacionin e duhur për të qarkulluar në mënyrë të sigurt dhe të ligjshme.
7. Për sa i përket ndricimit rrugor, duhet të respektohen normat Europiane të performancës së ndricimit EN 13201: Përzgjedhja e normës së ndricimit sipas PD CEN/TR 13201-1;2014.

8. Përcaktimi i kostos paraprake të ndërhyrjes në bazë të VKM nr. 216 datë 13.04.2023 *"Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve"*.
9. Pas vlersimit të materialeve nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit, do të jepet vendimi mbi vazhdimin e hartimit të projektit të zbatimit.

Faza e dytë, projekti i zbatimit:

2. Në këtë fazë në procesin e projektimit do të përfshihen vlerësimet dhe llogaritjet shoqëruar me relacionet dhe vizatimet përkatëse të specifikuara në mënyrë të detajuar referuar detyrës së projektimit.
3. Grupi projektues gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e shërbimit të oponencës dhe lejes së ndërtimit i cili duhet të mbështetet në ligjin Nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"* dhe V.K.M. Nr.1055/2010 *"Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit"* dhe në Urdhrin e Ministrisë Nr.197, datë 09.10.2014 *"Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponences teknike për projektet e veprave të ndërtimit"* i ndryshuar me Urdhrin Nr.243/2019. Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit të bashkëpunohet me Drejtoritë përkatëse të Bashkisë Patos.
1. *Projekti i zbatimit të krijimi të parkut rekreativ duhet të përmbajë*
 - Projektin e zbatimit me të gjithë elementët e parashikuar në projekt shoqëruar me relacionet, specifikimet apo llogaritjet përkatëse.
 - Përcaktimin e skemës së aksesueshmërisë dhe levizjes përgjatë gjithë parkut me sinjalistikën përkatëse.
 - Pozicionimin e zonave me sinjalistikën përkatëse vertikale, horizontale dhe me të gjithë elementët sigurisë.
 - Aksesueshmërinë nga personat me aftësi të kufizuara
 - Profilat tip, detaje arkitektonike, prerje pamje etj.
 - Sistemin e sheshit dhe përcaktimin e hapësirave për parkim, duke parashikuar zona të gjelbëra, hapësira rekreacioni etj.
 - Mobilimin urban në funksion të planit të sistemit të propozuar për zonën me të gjithë elementët e nevojshëm.
 - Sinjalistikën horizontale, vertikale.
 - Detaje të ndryshme të trotuareve, bordurave etj.
 - Projekti duhet të jetë i shoqëruar me relacion përkatës dhe specifikime teknike, ku relacioni teknik duhet të përmbajë:
 - a. Llogaritje analitike të strukturave
 - b. Të dhëna të sakta bazuar në gjendjen ekzistuese.
2. Projektin e ndriçimit rrugor, skema e furnizimit me energji elektrike dhe detajet përkatëse (Shoqëruar me relacion, llogaritjet teknike +specifikime teknike përkatëse)

3. Grafikon e punimeve.
4. Preventivin e punimeve sipas kategorive të punimeve i gjeneruar nga e-albania referuar VKM nr. 216 datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve". Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ofertat përkatëse të çmimeve.
5. Raportin e vlersimit të ndikimit në mjedis (VNM).
6. Plani organizimit të punimeve.
7. Materialet e sipërcituara duhen dorëzuar fizikisht dhe në formatet përkatëse: dwg., word, excel.
8. Dorëzimi final do të konsiderohet i gjithi materiali që ka kaluar fazat e mësipërme.

Termat e referencës janë hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Emergjencave Civile.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Specifikimet teknike janë hartuar nga Drejtoria Projekteve dhe Emergjencave Civile pranë institucionit Bashkia Patos në përputhje me objektin e prokurimit dhe nevojat e autoritetit kontraktor.

Shënim:

Referuar udhëzimeve të APP, për zërat në DST që mund të jete paraqitur marke/brand, operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përgatitjes së ofertes ekonomike. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 14.07.2025, ora 11:00.

NJËSIA E PROKURIMIT

Florian Kita

Mitjon Nikolla

Ermenita Mici